



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri
Mbledhja nr. 05
Data 7. 04. 2008

P R O C E S V E R B A L

Mbledhjen e kryesoi:
Rrustem Mustafa, kryetar i Komisionit

Të pranishëm në mbledhje ishin:
Shkumbin Demalija, Bojan Stojanović Emrush Xhemajli, Eqrem Kryeziu, Agim Veliu,
Gani Geci dhe Zylfi Merxha

Mungoi: Bujar Bukoshi, Naim Maloku, Zafir Berisha

Nga zyra mbështetëse morën pjesë: Nur Çeku, Antigona Ibraj

Vëzhgues të tjerë ishin: Armend Beka OSBE, Astrit Istrefi Saferworld, përfaqësues nga
OJQ FIQ, Nexhat Shatri Zyra Ligjore e Presidencës,

Mbledhja filloi në orën 11:00 në sallën N-10, në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës.

Mbledhja filloj me këtë rend dite:

R e n d i i d i t ë s :

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 26.03.2008
3. Shqyrtimi i planit për mbajtjen e dëgjimit para komisionit me segmentet e sigurisë në Kosovë
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Sigurinë Private
5. Të ndryshme

Pika e parë: Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

Pika e dytë: Procesverbali i mbledhjes së datës 26.03.2008, u miratua pa vërejtje.

Pika e tretë: Në lidhje me këtë pikë, kryetari i komisionit tha: Në mbledhjen e kaluar kemi diskutuar rreth mundësisë së organizimit të një dëgjimi para komisionit. Pra ju para vetës keni një draft se si do të organizohet dhe kush mund të ftohet në këtë dëgjim. Mirëpo nëse dikush nga ju ka diçka për të shtuar ne do ta plotësojmë sërish këtë plan. Ditën kur do të mbahet dëgjimi komisioni një orë me herët do të mblidhet me për të diskutuar rrjedhën e dëgjimit. Ne duhet ta caktojmë një datë e cila duhet të bëhet varësisht nga seanca plenare.

Emrush Xhemajli tha, unë në këtë plan shoh disa emra të cilët sipas mendimit tim nuk do të duhej te raportonin në këtë dëgjim si p.sh Sheremet Ahmeti sepse mendoj se ky ka rol dytësor, pra është zëvendës komisar, si dhe disa të tjerë që janë përfshi në këtë draft-plan.

Rrustem Mustafa tha, Emrush Xhemajli ka plotësisht të drejt, këtu janë disa emra për të cilët nuk është e nevojshme që ta kenë fjalën, unë mendoj që Ministri i MPB mos ta ketë kohen e limituar për debat ndërsa të tjerët duhet të kenë limit, gjithashtu mendoj se Komandantit të KFOR-it mund ti lejohet e drejta e fjalës.

Haxhi Merxha tha, unë propozoj qe ky dëgjim të mos caktohet ditëve të martë, sepse ne si shefa të grupeve parlamentare kemi mbledhje me kryesin.

Rrustem Mustafa propozoj që ky dëgjim të mbahet pas dy javëve, ndërsa çështjen e datës së saktë ta koordinoj stafi mbështetës varësisht nga zhvillimet në Kuvend.

Anëtarët u pajtuan me këtë propozim.

Pika e katërt: Në lidhje me këtë pikë kryetari i komisionit theksoi se pas miratimit ne parim në seance Projektligji për Sigurinë Private duhet të shqyrtohet ne komision tonë Propozoj që z. Emrush Xhemajlin referues për këtë projektligj. Anëtarët e komisionit u pajtuan me këtë propozim.

Emrush Xhemajli tha, ne jemi këtu për të punuar, besoi që stafi do te caktoj takime me kompanitë e sigurimeve, me organet kompetente për këtë projektligj dhe besoi se gjithçka do të kryhet me kohë.

Pika e pestë : Në lidhje me këtë pikë z. Shkumbin Demaliaj njoftoi anëtarët se Komisioni për Buxhet dhe financa në mbledhjen e vetë në lidhje me shqyrtimin e raportit dhe emërimin e tre anëtarëve në Këshillin e Agjencisë Kundër Korrupsionit, ka vendosur që me këtë çështje të merren grupet parlamentare.

Mbledhja përfundoj në orën 11:40.

Kryetari i Komisionit
Rrustem Mustafa